



SBASHK Arsimimi sot

Mars, 2023

Gazeta elektronike

Me aktivitete të shumta u shënua dita e mësuesit dhe shkollës shqipe
SBASHK me respekt të lartë për pishtarët e dijes

Aktivitete të SBASHK-ut në
pjesën e parë të muajit mars

Mbështetje mësimdhënësve
për ngritjen e vazhdueshme të
cilësisë në arsim

Duke u bazuar në kërkesat ...
(faqe 5)

Flasin për gazetën tonë disa
nga veteranët e SBASHK-ut



Edhe në fillimet e marsit të këtij viti SBASHK-u organizoi aktivitete të shumta për të shënuar ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror e në bashkëpunim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kishin përgatitur me kohë listat e kolegeve e kolegëve që janë pensionuar nga prilli i vitit 2022 e deri në marsin e këtij viti dhe pastaj kanë përgatitur më shumë se 600 mirënjohje në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e tyre nëpër vite e dekada për edukimin dhe arsimimin e brezave ... (faqe 4)



Ndjehemi të nderuar që nuk
po na harroni

Mosha dhe aty e këtu ...
(..faqe 3)

Një aktivitet modest për veprimtarët e hershëm
sindikalë

**Ruajnë kujtime të shumta nga angazhimet në
SBASHK.**



Me një aktivitet, që në shikim ... (faqe 4)

Takimi i radhës me kryetarët e nivelit komunal
sindikal e të Universiteteve

**Unitet dhe përkushtim në realizimin e aktiviteteve
sindikale drejtorin e
arsimit z.Bajselmani**



Duke realizuar agjendën e pjesëmarrjes ... (faqe 5)



Editorial

Edhe në këtë 7 mars mësuesi pa mbështetjen e duhur nga institucionet



Ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe SBASHK-u e shënoi me aktivitete të shumta nëpër komuna dhe Universitete. Duke bërë një analizë të situatës aktuale në arsim vërehet se mësuesi dhe shkolla në Kosovë nuk gëzojnë mbështetjen e duhur nga institucionet qendrore. Prandaj SBASHK i ka bërë thirrje MASHTI-t dhe institucioneve që të ndajnë më shumë mjete për sistemin arsimor, me qëllim që kushtet në shkolla të përmirësohen.

“SBASHK-u kërkon edhe në këtë datë të madhe nga ministria dhe institucionet që të ndajnë më shumë mjete për

sistemin arsimor me qëllim që kushtet e punës në shkolla të përmirësohen dukshëm ngase edhe ky 7 mars punëtorët e arsimit i gjen kryesisht me mjete të punës si shkurtesa e shpuza dhe me tekste shkollore që shpesh janë kritikuar nga ekspertët dhe të cilat nuk korrespondojnë as me kurikulën. Jemi të sigurt që mësuesit dëshirojnë që të jenë më të mirë nesër se sot, por për të qenë të tillë duhet të jenë të ndihmuar, e jo të fyhet figura e mësuesit publikisht”, ka deklaruar SBASHK-u publikisht edhe në ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.


Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Flasin për gazetën tonë disa nga veteranët e SBASHK-ut
Ndjehemi të nderuar që nuk po na harroni



*Mosha dhe aty e këtu
ndonjë sëmundje
ua ka bërë të
vështirë udhëtimin
veteranëve të
SBASHK-ut dhe
takimin me njëri-
tjetrin për të
bashkëbiseduar e*

*për të kujtuar vitet e shumta në procesin edukativ
e arsimor dhe në aktivitetet sindikal . SBASHK-u
vlerëson lartë përkushtimin e tyre në shërbim të
anëtarësisë dhe prandaj organizoi një aktivitet
modest për veteranët e SBASHK-ut. Ata u shprehen
të nderuar dhe falënderuan SBASHK-un për këtë
gjest që siç thanë ata, ka domethënie e vlerë të
veçantë për ta. Biseduam me disa prej tyre për
gazetën tonë të muajit mars.*

Kadri Thaçi

E përgëzoj SBASHK-un për këtë aktivitet shumë domethënës. Stafi qendror po dëshmon se nuk i ka harruar veprimtarët sindikalë. Ky aktivitet i organizuar për mrekulli më mundësoi që të takohem e të bashkëbisedoj me gjithë kolegët e mi e të kujtojmë vitet e dekadat e kaluara në arsim dhe në aktivitetet sindikale. Me shumë nga ata ka kohë që nuk jam takuar dhe ishte ky një rast i shkëlqyer për biseda e shpalosje të kujtimeve të shumta. Faleminderit SBASHK.

Ibish Maksuti

Ftesa nga SBASHK-u për këtë aktivitet më bëri të ndjehem mirë. Nuk na paskan harruar, thashë dhe me kureshtje shikova listën. Duke lexuar emra më shpaloseshin vetvetiu shumë kujtime nga aktivitetet e përbashkëta sindikale nëpër vite e dekada. U angazhuam edhe në kohë të vështira, por bashkërisht ia dolëm. Ne të gjithë përcjellim angazhimet e SBASHK-ut dhe ndajmë bashkë shqetësimet dhe krenarinë për arritjet e shumta.

Sadik Shala

Shpreh respekt të lartë për stafin qendror të SBASHK-ut që organizoi këtë aktivitet shumë të qëlluar e domethënës. U dëshmua se ata nuk na harrojnë kurrë e as ne nuk e harrojmë SBASHK-un po ndjehemi edhe sot e gjithmonë si pjesë e sindikatës sonë. U takova me kolegët e mi dhe ata duke më nxitur u rikujtova shumë nga rrëfimet humoristike që ua tregoja dikur. Humori i lehtë ishte pjesë e këtij aktiviteti të qëlluar.

Murat Kryeziu

Vërtetë ishte një aktivitet shumë domethënës për ne. U takuam edhe një herë ne veprimtarët sindikalë, që dikur u angazhuam bashkërisht në shërbim të anëtarësisë. Ky takim sikur i rinoi të gjithë dhe ata bashkëbisedonin dhe qesheshin me humorin që tregohej nga disa kolegë tanë. Biseduam edhe për vitet e kaluara në arsim dhe në aktivitetet sindikale. Besoj se SBASHK-u do të vazhdojë me këtë traditë dhe ne do të takohemi për të bashkëbiseduar, por edhe për të lartësuar kujtimin për veteranët e SBASHK-ut që më nuk janë mes nesh. I përjetshëm qoftë kujtimi për ta.

Ajet Reshiti

Ishte ky një aktivitet i veçantë dhe unë me kënaqësi mora pjesë në të. U takova me veprimtarët sindikalë dhe i kthyem kujtimet në kohët e shkuara. Kujtuam edhe kohët plot sfida dhe angazhimin plot sakrifica të pishtarëve të dijes në mbrojtje të arsimit shqip. Kujtuam edhe vitet e pasluftës dhe gjithë kontributin e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit. E përgëzoj dhe e falënderoj SBASHK-un për këtë aktivitet të veçantë për ne.

Gjatë muajit

Me aktivitete të shumta u shënuar dita e mësuesit dhe shkollës shqipe
SBASHK me respekt të lartë për pishtarët e dijes

Edhe në fillimet e marsit të këtij viti SBASHK-u organizoi aktivitete të shumta për të shënuar ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror e në bashkëpunim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kishin përgatitur me kohë listat e kolegeve e kolegëve që janë pensionuar nga prilli i vitit 2022 e deri në marsin e këtij viti dhe pastaj kanë përgatitur më shumë se 600 mirënjohje në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e tyre nëpër vite e dekada për edukimin dhe arsimimin e brezave.



dhe gjithë pasardhësit e tyre që nëpër kohë furtunash mbrojtën dritën kundër errësirës që mundoheshin ta sjellin e rrënjosnin mbi atdheun tonë pushtuesit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve festive të organizuara kudo në Kosovë për ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe u janë ndarë këtyre pishtarëve të dijes mirënjohjet e përgatitura nga SBASHK.



Në disa komuna pjesë e këtyre aktiviteteve kanë qenë edhe kryetarët e komunave dhe zyrtarë të tjerë komunalë të cilët kanë uruar për ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe dhe kanë shprehur respekt për përkushtimin e të pensionuarve nëpër vite e dekada në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave. SBASHK falënderon kryetarët dhe zyrtarët tjerë komunalë që janë bërë pjesë e këtyre aktiviteteve festive.

Pas kësaj kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë organizuar takime në atmosferë feste për të kujtuar me krenari pishtarët e parë të dijes

Një aktivitet modest për veprimtarët e hershëm sindikalë **Ruajnë kujtime të shumta nga angazhimet në SBASHK**

Me një aktivitet, që në shikim të parë duket modest, SBASHK-u vazhdon të dëshmojë se nuk i harron veprimtarët sindikalë që në vite e dekada janë angazhuar në gjithë angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Kështu ndodhi edhe këtë vit dhe pikërisht në muajin që shënon ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Stafi qendror me kujdes po shikonte listën e veteranëve të SBASHK-ut ngase nuk duhej harruar as njëri nga ata. Duke shikuar listën e përgatitur në vitin e kaluar, u kthyen momentet e dhembjes sepse 7 nga veteranët në listë kanë kaluar në botën e amshuar. Ky fakt e bën edhe më të rëndësishëm e domethënës këtë aktivitetin modest kushtuar këtyre pishtarëve të dijes dhe veprimtarëve të hershëm të sindikatës sonë.

I thirrëm në telefon një nga një me drojën se do të më tregojnë se janë keq me shëndetin dhe gëzoheshim kur përgjigjeshin e flisnin me atë zërin që isha mësuar ta dëgjojmë gjatë komunikimeve me ta. Edhe ata, që moshë u kishte lënë pak më shumë gjurmë, nga ndjenja e krenarisë për SBASHK-un dhe dëshira që të takoheshin e të bashkëbisedonin me kolegët, i thanë po këtij aktiviteti.

Veteranët e SBASHK-ut u bashkuan prapë, tani jo për të marrë vendime, por për të shpalosur kujtime për angazhimet e shumta në SBASHK. Ndjeheshin krenar me SBASHK-un, ndjeheshin mirë që sindikata e tyre nuk i ka harruar.



Takimi i radhës me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve Unitet dhe përkushtim në realizimin e aktiviteteve sindikale

SBASHK-u në orët e mbrëmjes së të mërkurës ka mbajtur mbledhjen e radhës me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Në hapje të këtij takimi nga larg, kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka përgëzuar të pranishmit për gjithë angazhimet dhe u ka bërë thirrje që të vazhdojnë me përkushtimin në realizim të detyrave konkrete në shërbim të anëtarësisë. Ai pastaj ka bërë një përshkrim të aktiviteteve të niveli qendror në pjesën e parë të këtij viti. Lidhur me këto angazhime kanë dhënë detaje edhe nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Pas kësaj është bashkëbiseduar për vazhdimin e traditës së mirë për dërgimin e një numri të konsideruar të anëtarëve në bregdetin shqiptar si shenjë mirënjohje për angazhimin e tyre në misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave. Ishte vendim i përbashkët që të fillohet me përgatitjet me qëllim që ky aktivitet të realizohet me sukses të plotë si edhe viteve të kaluara. Në këtë takim është bërë edhe një analizë e procesit të regjistrimit në eKosova dhe është thënë se ky proces po vazhdon.

Pjesëmarrësit e këtij takimi kanë bashkëbiseduar edhe për iniciativën që edhe SBASHK të marr pjesë në marshin për drejtësi, i cili do të mbahet në kryeqytetin e Kosovës më 2 prill. Lidhur me këtë angazhim nga takimi u mor vendim në të cilin thuhet: “SBASHK në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve përveç për temat aktuale në arsim dhe në aktivitetet sindikale ka bashkëbiseduar edhe për kërkesën e shumë kolegeve e kolegëve tanë që nga çerdhet e deri në Universitete për mbështetjen e aktivitetit “Marshojmë për drejtësi” organizuar nga iniciativa “Liria ka emër”. Në këtë takim pjesëmarrësit njëzëri kanë vendosur që edhe SBASHK me një numër të konsideruar të anëtarësisë të marr pjesë në këtë aktivitet.”



Në takim janë debatuar edhe çështje të ngritura nga pjesëmarrësit që kanë të bëjnë me aktivitetet sindikale në komuna

Aktivitete të SBASHK-ut në pjesën e parë të muajit mars

Mbështetje mësimdhënësve për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim

Duke u bazuar në kërkesat e një numri të konsideruar të punëtorëve arsimor SBASHK edhe në pjesën e parë të muajit mars ka vazhduar të organizojë trajnime bazuar në vullnetin e anëtarësisë. Ky aktivitet ka vazhduar të organizohet me sukses falë përkushtimit të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafit qendror, trajnerëve të angazhuar dhe disa prej kryetarëve të nivelit komunal sindikal. Në këtë numër të gazetës sonë do të përmendim trajnimet e mbajtura me sukses nëpër disa komuna të Kosovës duke përgëzuar pjesëmarrësit për angazhimin dhe trajnerët për përkushtimin që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

I përgëzojmë koleget e kolegët tanë në Prizren për përkushtimin e treguar në trajnimet trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimin e tyre në shkollat fillore”, Mësimdhënia e gjuhës shqipe për ciklin fillor e të mesëm”, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”. SBASHK falënderon trajnerët prof. dr. Bardh Rugova, prof. dr. Hysen Sogojeva, Pranvera Haziri, Esyngyl Dinovci, Albert Samadraxha, Arben Zymeri, Nexhmedin Gruda dhe Xhelal Krasniqi, që me



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

angazhimin e tyre maksimal kontribuan që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe të përfundojë me sukses.

Komuna e Prizrenit është dalluar me kërkesat e mësimdhënësve për organizimin e trajnimeve të licencuara. Veçojmë edhe trajnimin “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore” me trajneren Esyngyl Dinovci. Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin koleget e kolegët tanë nga komuniteti boshnjak. Vlen të përmendet edhe trajnimi “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës” me trajneren Drita Kamberi.



Ky aktivitet në pjesën e parë të marsit është zhvilluar edhe në Kamenicë me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, udhëhequr nga trajnerët Adhurim Maka dhe Fadil Gashi.



Trajnime janë organizuar edhe në komunën e Podujevës “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” me trajneren Nora Haliti dhe trajnimi “Udhëheqja

dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me trajnerin Fahri Hoxha dhe në Skenderaj “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me dr. Safet Beqiri.



Në Suharekë në përmbyllje të pjesës së parë të trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, udhëhequr nga trajnerët Bahrije Elshani e Emin Hoxha pjesëmarrësit kanë dëshmuar njohuritë e arritura përmes testin që e kanë monitoruar Ymer Ymeri e Blendor Shatri nga stafi qendror i SBASHK-ut. Në këtë komunë me sukses përfunduan trajnimet “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore” me trajnerin Ahiret Mehmeti dhe “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar” me trajnerët Agim Hasani dhe Nora Ajeti.



Kontribut në rrjedhën e mbarë dhe përfundimin me sukses të këtyre trajnimeve kanë dhënë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe anëtarët e stafit qendror Blendor Shatri, Nezafete Jakupi e Vlora Rexhepi Berisha dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal, të cilët në kuadër të zhvillimit të këtij aktiviteti edhe kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit duke u përgjigjur edhe në pyetjet e tyre.



Ata bashkë me pjesëmarrësit e këtij aktiviteti kanë shprehur respekt meritore për angazhimet e shumta në stafit qendror në shërbim të anëtarësisë.

Një ngjarje e veçantë për arsimin e lartë në Kosovë

Partneriteti strategjik me Universitetin Shtetëror të Arizonës dhe Kolegjit Universum

Në historikun e arsimit të lartë në Kosovë 30 marsi i vitit 2023 do të zë vend meritore sepse u bë lansimi i partneritetit strategjik në mes të Universitetit Shtetëror të Arizonës dhe Kolegjit “Universum”. Kjo ngjarje e veçantë u zhvillua në ambientet e bukura të Klan Arena dhe pjesë e saj kanë qenë edhe kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe anëtarët e stafit qendror Blendor Shatri e Nezafete Jakupi.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në hapje të kësaj feste presidenti i “Universum International College”, z. Alejtin Berisha ka folur për angazhimet e këtij institucioni arsimor nëpër vite dhe për arritjet e shumta e të vazhdueshme të kësaj vatre të arsimit të lartë. Emri dhe imazhi i krijuar me punë e përkushtim ka rezultuar edhe me këtë arritje kulmore të partneritetit strategjik me njërin nga Universitetet e njohura në SHBA.



Duke ndarë gëzimin me pjesëmarrësit për këtë arritje ambasadori i SHBA në Kosovë, shkëlqesia e tij Jeffrey

M. Hovenier ka mbajtur një fjalë rasti duke përgëzuar të punësuarit të këtij institucion arsimor e duke u shprehur i bindur se partneriteti me një Universitet publik nga SHBA do të jetë në dobi të një arsimit të lartë shumë cilësor në Kosovë. Përmes një videolinku pjesëmarrësit e kësaj ngjarje të veçantë i ka përshëndetur edhe presidentja e Kosovës Vjosa Osmani.



Pjesëmarrësve u janë drejtuar ekspertë të lartë të arsimit Dr. Chris Hovard dhe dr. Rick Shangav. Në pjesën e dytë të këtij manifestimi Rektorja e Kolegjit Internacional Univerisum, dr. Shqipe Gërguri Rashiti ka prezantuar një plan të detajuar për kahet e punës dhe aktivitetit të këtij institucioni të arsimit të lartë në vitet e ardhshme.

